

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE

“3 FAM ENERGY” shpk

Fier më datë 15/09/2022

NENI 1

Shoqëria Tregtare “3 FAM ENERGY” sh.p.k (në vazhdim Shoqëria) formohet si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” të ndryshuar dhe do të funksionojë në bazë të këtij akti themelimi dhe statuti të miratuara prej saj.

NENI 2

Emri i Shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko-civil me emrin “3 FAM ENERGY” sh.p.k

NENI 3

Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të ketë si objekt ushtrimin e të gjitha veprimtarive në fushën e energjisë.

Konkretisht:

- 1) Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë;
- 2) Prodhimi i gazit; shpërndarja e lëndëve të gazta nëpërmjet tubacioneve;
- 3) Projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i centraleve për prodhimin e energjisë dhe infrastruktura e impianteve. Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë;
- 4) Asistenca teknike, riparime dhe mirëmbajtja e aparaturave për prodhimin e energjisë. Import- eksporti, tregtimi me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparaturave që lidhen me kryerjen e aktivitetit në fushën e energjisë;
- 5) Instalimi dhe ndërtimi i impianteve energjitike nga burime të rinovueshme nga dielli, era, uji, etj;
- 6) Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë nga burime të rinovueshme;
- 7) Importi dhe eksporti i mallrave e pajisjeve të teknologjisë në fushën e energjetikës, që do të përdoren në ndërtimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e centraleve me impiante fotovoltaike e forma të tjera të prodhimit të energjisë të ushqyera nga burime të ndryshme dhe nga ato të caktuara si: hidroelektrike, diellore, me crë, biomasa etj;
- 8) Mirëmbajtja e centraleve energjitike;
- 9) Zhvillim të projekteve në sektorin e energjive të rinovueshme, ndërtimin dhe mirëmbajtje të punimeve civile, objekteve të ndryshme, linjave elektrike, kërkim dhe zhvillim të shpellave dhe minierave.

NENI 4

Selia e Shoqërisë

- 1) Selia e Shoqërisë ndodhet në adresë: Fier ,Lagjja "11 Janari" Rruga "Ramiz Aranitasi"Zona kadastrale nr.8534. Pasuria me numër 6/136 Ish Banka e vjeter.Kati i dyte

2) Adresat e komunikimit elektronik të shoqërisë janë: alban.kajolli@yahoo.com

NENI 5 **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i nënshkruar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie, në para në vlerën 100.000 lekë. Kapitali ndahet në 1 (një) pjesë dhe pronësia e kuotave nga ortakët e shoqërisë vijon si më poshtë:

- 1) Alban Kajolli në cilësinë e ortakut themelues zotëron 100 % të vlerës së kapitalit themeltar, e barabartë me 1 kuotë me vlerë 100.000 Lekë.

Kapitali themeltar investohet nga ortaku themelues në para. Pagesa e kapitalit themeltar kryhet nga Ortakët themelues mbas regjistrimit në Qëndren Kombëtare të Biznesit.

NENI 6 **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar. Afati i aktivitetit fillon mbas regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar.

NENI 7 **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008” Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- 1) Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimmarrës;
- 2) Administrator – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë.

Shoqëria do të administrohet nga Administratori, i cili zgjidhet për një afat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

Administratori i parë i shoqërisë është z. Alban Kajolli lindur më 08.12.1993 në Fier, Shqipëri, shtetas shqiptar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit nr.037873792 dhe nr. personal J31208067U cel.0674008088.


Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, entit publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 8

Ekspertët kontabël të autorizuar të Shoqërisë do të emërohen në përputhje me ligjin në fuqi dhe për çdo vit financiar vjetor për veprimtarinë e shoqërisë.

NENI 9

Ortakët themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.



NENI 10

Organizimi dhe funksionimi i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

NENI 11

Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

NENI 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshje që mund të lindin midis ortakëve apo midis ortakëve dhe Shoqërisë dhe të cilët mund të kenë si objekt të drejta si rrjedhim i raporteve me shoqërinë do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

NENI 13

Dispozitat përfundimtare

Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

3 FAM ENERGY

1.Ortaku i vetëm themelues Alban Kajolli

Alban Kajolli
A.K.